



Përballja e shqipes me anglishten-interpretimi dhe përkthimi i termave mjekesorë

Msc. Miranda Mane

Abstract

Being in day to day contact with English as the result of the social and economic, and above all the global political changes which affected our soils as well, Albanian encounters obstacles of diverse nature especially on the way of interpretation and translation of medical terms. Through a comprehensive analysis in this theme are presented the positive and negative impact of the contacts of English and Albanian, shedding light on a number of interrelated factors that result in the interpretation and translation of English language into the Albanian one. In consequence, communication is facilitated on the one hand, and impeded on the other.

Key words: English, contact, translation-interpretation, illness, sickness, disease, Albanian.

Abstrakt

Shqipja, duke qene ne kontakt të perditshem me anglishten, si rrjedhoje e ndryshimeve shoqerore dhe ekonomike, por ne radhe të pare ndryshimeve globale politike, ne keto perballje po has ne veshtiresi natyrash të ndryshme, ne veçanti me menyren e interpretimit dhe perkthimit të termave të ndryshme mjekesore. Permes një analize të gjithanshme, ne kete teme paraqiten ndikimet pozitive dhe negative të kontakteve të anglishtes me shqipen, duke hedhur drite mbi një varg faktoresh që ndikojne ne interpretimin dhe perkthimin e gjuhes angleze ne gjuhen shqipe, që rezulton sa ne lehtesimin e komunikimit nga njera ane, po aq edhe ne veshtiresimin dhe pengimin e tij nga ana tjeter. Te kjo teme do të parashtrohen tre nocione kyce të fjales semundje ku perkatesisht ne anglisht keto fjale shprehen me termat illness, sickness, dhe disease.

Fjalet kyçe: anglishtja, kontakt, perkthim-interpretim, semundje, shqipja.

Hyrje

Çdo epokë karakterizohet nga tipare dalluese të cilat shfaqen në çdo aspekt të jetës. Epoka jonë, në menyren me paradoksale të mundshme është sa gjithepershiresë aq dhe individuale, ne të njejtën kohe. Kombet ne mbare boten nuk kane qene asnjehere aq të mevetesishem gjeografikisht dhe politikisht sa tani dhe ne të njejtën kohe komunikimi, shkembimi dhe marrëdhëniet mes tyre po rrezojne një nga një kufijte anembane globit. Çdo dite po i afrohem gjithnje e me shume realizimit të fshatit (te bere tashme qytet) global. Ne vitin 1500 ne Evrope ekzistonin 500 entitete politike. Aty rreth viteve 20-te të shekullit të kaluar ishin vetem 23, nderkohe që pjesa me e madhe e shteteve janë të krijuara pas vitit 1945. Ketu ka luajtur një rol të rëndesishem zhvillimi ekonomik dhe projektimi politik.

Ajo që na shpaloset para syve, është një bote e larmishme e perbere dhe e gershetuar nga shume mini të tilla apo kultura po aq të vogla, lokale, rajonale dhe kombetare, shume nga të cilat nuk kane asgje apo fare pak të perbashket. Keshtu globalizimi na vjen ne menyra të ndryshme. Shpesh kuptohet si globalizimi i ideve dhe realiteteve të botes shumegjuhesore dhe shumekulturore, si globalizem i bashkepunimit dhe kembimit të barabarte të ideve dhe vlerave kulturore, si integrim ne tregjet financiare, ne tregjet e mallrave dhe sherbimeve, si levizshmeri e madhe ne njerez dhe kapitale, por shpesh kuptohet edhe si zgjerim i dhunshem i sferes se ndikimit të grupit të vendeve me të fuqishme.

Ne qofte se kronopolitika e globalizimit ndikon tek imazhi i gjuheve, si po ndryshon prezantimi i statusit të vete perkthyesve ne epoken e globalizimit? Gjate një periudhe 800 vjeçare kemi levizur nga vargonj të medhenj me masa të lidhura me lesh, drejt tavolinave të manastireve dhe drejt disqeve të cilat mund të futen brenda xhepit të xhaketes. Mesazhet e shkruara ose dokumentat e bashkangjitura fluturojne rreth e qark botes brenda disa minutave apo sekondave. Fjala e urte Latine, *verba Volant et scripta manent* duhet të riformulohet pasi tani



si '*scripta*' dhe '*verba*' fluturojnë ne ajer.

Per të arritur integrimin ne rrjetin global të veprimtarive ne fushat e ndryshme nevojitet një proces sa me i qarte dhe i rrjedhshem komunikimi. Ne një bote, ku me gjithë dominimin e gjuhes angleze ne të ashtuquajturin komunikim global, perkthimi vazhdon të mbetet një nga instrumentet me thelbesore të realizimit me sukses të ketij procesi sa të nderlikuar ne ingranazhet perberes të tij aq edhe ne pasojat që le ne kulturen dhe gjuhen pritesë. Faktet e permendur me lart janë disa prej faktoreve të jashtem të cilet argumentojne ne një menyre a një tjetër arsytet për zgjedhjen e kesaj teme e cila qendron si hipoteze me vete formulimin e saj. Arsyet e brendshme janë akoma edhe me të forta.

Ne fillim si studente prane departamentit të gjuhes angleze të Fakultetit të Gjuheve të Huaja, të Universitetit të Vlores e me pas ne keto dy vjet mesimediane, gjuha dhe terminologjia kane qene gjithmone një burim interesant diskutimesh dhe problematikash për sa kohe që paraqet figurshmeri dhe forma perhere e me të sofistikuara shprehjesh. Puna ne auditor ne të dy rolet e siperpermendura është drejtuar gjithmone ne menyre të vullnetshme ose jo drejt zgjidhjes se të njejtës pyetjeje: Sa komunikohet kur perkthehet dhe sa perkthehet kur komunikohet ne terma kulturore, ne gjuhen e pergjithshme dhe ate specifikesht të perdorur ne një fushë të caktuar, siç është edhe ajo mjekesore.

Ne qofte se globalizimi kulturor dhe gjuhesor realizohet si unifikim gradual. A mos është ky rasti ku gjuhet e vogla, e për pasoje kulturat e vogla, duhet të menjahohen ne kurriz të ndikimit të një gjuhe e kulture me të madhe? Kjo është një nga pyetjet kyce të ciles perpiqet ti jape pergjigje ky punim. Ndersa mendojme se komunikimi nderkulturor si një forme që merr perkthimi tek kalon elemente të kultures nga njera ane e bregut gjuhesore ne tjetrin, është i pashmangshem, sa "rrezikon" kulturalisht shoqeria e vendit ne fjale të humbase një rrenje teksta fiton një dege? Parakushti, edhe pse paradoksal, për t'u bere pjese e globales është ruajtia e identitetit që na ben të veçante.

Sic dihet tashme, e gjithë veprimtaria njerezore po njeh gjithmone e me pak kufinj gjeografik. Ajo që ne fakt po thyen edhe ato gjuhesore është veprimtaria ekonomike. Duke e krahasuar me të tjerat, kjo është një marrëdhënie e cila e ka shoqeruar njerezimin që ne zanafillen e tij e me pas me zgjerimin e njohurive të njeriut mbi boten, shkembimet e natyres tregtare kane pesuar rritje gjithashtu. Për kete arsye është menduar se ekonomia globale dhe ajo shqiptare para dhe pas viteve '90 do të jepte një pamje dhe kontekst domethenes për të vertetuar barazimin e famshem "pa perkthim, nuk ka produkt" për të zgjidhur me pas ekuacionin se sa komunikojme kulturalisht kur perkthejme.

Ne kete punim është menduar të jepet një panorame

e perkthimit, duke e zberthyer kuptimin e ketij procesi të rendesishem, i cili ka një impakt të jashtezakonshem ne jeten e perditshme të shoqerise tone për sa kohe ne pranojme faktin që ekzistenca e kesaj të fundit po ndertohet gjithmone e me shume mbi informacionin. Ne kete menyre do të tentohet të zberthehen kuptimet e ndryshme të perkthimit, duke nxjerre ne pah termat kyce të cilet do ta konkretizojne me teper kete nocion sa abstrakt aq edhe konkret. Nepermjet ketij punimi do të prezantohen variabla të ndryshem. Perkthimi ekziston edhe ndermjet varianteve të se njejtës gjuhe dhe ndermjet atyre që mund të konsiderohen si gjuhe me pak konvencionale si për shembull breil, kodi mors etj.

Por ne rastet kur një flamur identifikohet me një shtet, kombesi, apo gjuhe, a do të konsiderohet procesi shoqerues mendor si perkthim? Ne rastin e fenomeneve që hasim ne jeten e perditshme si shenja e ndalimit të pirjes se duhanit, apo ikona ne ekranin e kompjuterit ne formen e një ore rere, a do të konsiderohet zberthimi logjik që behet si perkthim? Ne kete punim mendohet t'i kthehet pergjigje midis të tjerash edhe ketyre pyetjeve.

Sot mendohet se kultura i perket një shoqerie të caktuar: japonezet kane kulturen e tyre, francezet kulturen e tyre e keshtu me rradhe. Por kjo ide po nderlikohet gjithnje e me shume. Ne i perkasim një kulture të veçante kombetare, por nga ana tjetër, ne boten ku jetojme, zgjedhim edhe aspekte të jetes nga ai që mund të quhet "supermarketi kulturor global".

Nje pasoje e kesaj situate mund të jete dhe kontradita me të cilen perballemi çdo dite. Ndjeyme se i perkasim një kulture të caktuar globale të cilen e vleresojme. Por nga ana tjetër ne çdo dite vazhdojme të konsumojme e konsumohemi ne një bote ku komunikohet me gjeste e fjale.

Ne gjithashtu dime se si ndikojne aspekte si identiteti kulturor, globalizimi dhe kozmopolitanizmi ne komunikimin mes kulturave të ndryshme. janë pikerisht keto aspekte që e kane bere edhe me të mprehte problematiken e perplasjes mes globales ne kendveshtrimin gjuhesor dhe kulturor të fjales.

Ne kete pjese mendohet t'i kushtohet vemendje vleresimit apo jo të kultures globale si një kulture e standardizuar ne tere boten dhe pozicionimit dhe ndikimit të gjuhes angleze. Retrospektivat e mijeveçarit dhe parashikimet vazhdojne ta trajtojne kete gjuhe si simbolin e duhur për të konceptuar me mire globalizimin, dallueshmerine, progresin dhe identitetin. Megjithate historite e gjuheve na keshillojne të jemi të kujdesshem kur flasim apo bejme parashikime mbi të ardhmen e gjuheve.

Pasi janë evidentuar dhe prezantuar konceptime të ndryshme mbi perkthimin si fenomen dhe proces dhe me pas mbi komunikimin nderkulturor dhe aspektet e tij bashkekohore, mundohemi të hedhim drite mbi dallimet



dhe gjashmerite midis ketyre dy proceseve sa natyrale aq edhe të detyruara nga rrethanat dhe situatat e ndryshme. Do të vazhdojme me tej për të gjetur menyren se si të konceptohet sa me mire perkthimi ne një bote moderne plot ndryshime të mundshme. Ketu mendohet të kundërshtohet ideja e gabuar që është krijuar mbi perkthimin duke e trajtuar kete të fundit jo vetem si praktike që i pershtatet kushteve bashkekohore por të afte gjithashtu të shpjegoje, nepermjet rolit të tij si ndermjetes mes kulturave, një sere tiparesh të situates aktuale. Duke ndjekur kete logjike dhe për të mbeshtetur kete argumentim, mundohemi të shqyrtojme edhe pozicionin e atyre perkthyesve që shihen dhe degjohen njekohesisht ne boten moderne, interpreteve. Ne një bote ku të folurit, ne format e ndryshme që ka dhe merr, vazhdon të kete një rendesi të veçante, argumentohet nevoja për të kuptuar rolin e interpreteve pergjate historise. Ne një pike kyce gjate analizimit të rolit të interpretit apo perkthyesit është marrdhenia që ekziston midis gjuhes se perdorur dhe atij vete. Analizohen raste nga perkthyes reale apo imagjinare, për të konceptuar dhe pozicionuar veç rolit të interpretit dhe ceshtjen e perkthimit si boshtin e bisedimeve kur behet fjale për identitetin dhe pushtetin ne një bote të ndare si kjo e jona.

Pritshmeria e një analizimi të tille ne forme spirale, duke u munduar të arrijme specifiken ne një shumellojshmeri shembujsh nga fusha të ndryshme, ne kete pike do të ishte evidentimi i fushave të veprimtarise se kultures shqiptare të cilat bartin peshen me të madhe të marrjes dhe dhenies (me shume marrje se sa dhenie), ne kontekstin e perkthimit si komunikim nderkulturor ne kufinjte e të qenurit të njeanshem. Njekahshmeria e procesit të komunikimit mendohet se ndodh si pasoje e statusit të gjuhes shqipe si gjuhe pakice krahasuar me gjuhete tjera ne rajon e bote, bazuar ne numrin e shqipfolesve.

Duke bere një analize të gjendjes aktuale të shqipes ne pergjithsi, ku prurjet e huaja meqenese shenjojne shpesh here një realitet të ndryshem nga ai shqiptar, do të sjellin elemente të rinj, ku është menduar të zbulohen disa nga shkaqet e ketij fenomeni i cili brenda disa kufinjve do të argumentohet si normal dhe i zakonshem. Me një prerje sinkronike dhe nepermjet një vezhgimi diakronik shihet se si e tatepjeta e një gjuhe ka shkaqe politike dhe ekonomike. Pamja që mendohet të na shpaloset para syve, kur shihet sistemi ekonomik i para viteve '90, do të jete ajo e një gjuhe e cila pasqyron të njejtin izolim dhe shkeputje që njohu dhe shoqeria shqiptare. Perkthimi ishte një forme e cunguar komunikimi, i diktuar nga rrethanat dhe nen didaktin e barazimit: "çdo gje e huaj, është e denueshme".

Nepermjet analizimit të asaj që po ndodh sot ne ekonomine shqiptare, dhe rasteve të cilat e kapultojne kete ekonomi dhe shoqerine që e ve ne veprim, e kulturen e gjuhen që i japin ze, ne kornizen shumeplanesh e

shumengjyreshe të globales, është menduar të jepen prova të mjaftueshme ku perkthimi ka marre format e komunikimit nderkulturor. Shohim se si imponimi i gjuhes se mediave dhe asaj bisedore si stile funksionale ka rregjuar se tepermi edhe ate status e leksik të formuar me aq mund dy dekada me pare. Nese perkthimi është ne rastin me tipik një proces i cili nderton ura komunikimi, dhe ne fakt shume janë thene ne lidhje me faktin se si ai mbyll hendeqe të cilat ekzistojne midis kulturave të ndryshme, nuk duhet harruar se perkthimi është po aq i interesuar të veçoje sa dhe të lidhe. Për ta thene ne një menyre tjeter, studiuesit e perkthimit duhet të jene pararoje e fushatave për të mbrojtur dhe nxitur hapjen ndaj gjuheve të huaja për sa kohe që nuk ka kuptim të lidhesh kur nuk ka asgje për të lidhur. Ndertimi i urrave të komunikimit merre vlere sepse ekzistojne gjuhe dhe kultura të veçanta si dhe praktikuese të zote të ketyre gjuheve.

Sfondi teorik

Gjate perkthimit të një teksti mjekesor, duhet të dalloja shprehimisht ne shqip tre nocione kyce, të cilat ne anglishte autori i kishte shprehur perkatesisht me fjalet illness, sickness, dhe disease duke specifikuar se illness është semundja e perjetuar nga subjekti; sickness është semundja e perceptuar nga të tjeret, komuniteti ose shoqeria; dhe disease është semundja që perben objekt të dijes dhe artit të mjekut. Krejt teksti mbeshtetej ne dallimin midis ketyre tre nocioneve, prandaj i njejt dallim terminologjik duhej të percillej dhe ne gjuhen pritese.

Te perkthesh ne shqip është e veshtire ne raste të tilla sepse vete shqipja të le ne balte. Meqe thjeshte fjala semundje nuk mjafton, madje jo vetem nuk mjafton por edhe demton të percjellet e kuptimit, për aq kohe sa ajo fjale, duke sherbyer si ombrelle kuptimesh, anullon pikerisht ato dallesa të cilat teksti ne fjale kerkon të sqaroje.

Te gjitha keto nuk janë dallime pa rendesi. Une mund ta perjetoj semundjen time (illness) shume me ndryshe nga sa e perceptojne të tjeret, nderkohe që është perjetimi nga të tjeret (sickness) që percakton statusin tim, si i semure, brenda familjes, komunitetit dhe shoqerise; dhe ne fund trajtimin e kesaj semundje (disease) do ta vendose mjeku, ne baze të kriterereve që janë specifike për dijen dhe artin e tij.

Ne kete menyre, një skizofren mund të ndihet i lumtur ne crregullimin e vet mendor, të mos e ndieje (illness-in), por të perbeje shqetesim të madh për familjen dhe komunitetin, të cilet mund të vendosin edhe që ta spitalizojne (shtrijne ne spital) dhe cfare do të ndodh me kete pacient ne spital, kete e vendos mjeku, i cili e shnderron sickness-in e pacientit ne disease, duke i dhene atij trajtimin perkates.

Po ashtu, une mund të kthehem nga një vend ku kam



jetuar dhe punuar për një periudhe kohe. Vendi nga jam kthyer është Afrika dhe kthehem nga ky vend me një formë të lehtë të koleres, shenje e se ciles mund të jete dhimbje barku-illness, por semundja ime është e rrezikshme për komunitetin – sickness dhe kërkon veçim nga komuniteti ose futjen ne karantine për të parandaluar ngjitjen e kesaj semundje si dhe trajtimin perkates – disease. Perkundrazi, une mund të kem probleme të medha me dhimbje kronike të shpines apo të muskujve (illness), por megjithate shoqeria mund të mos e perceptoje fare kete problem timin, ose mund ta shperfillte duke e komentuar thjesht si çeshtje "nervash", nderkohe që mjeku i ve një emer "fibromialgji -si disease" dhe percakton trajtimin perkates.

Formulimi i problemit dhe qellimi i hulumtimit

Problemi është – si t'i japesh keto koncepte ne gjuhen shqipe pa u hallakatur ne neologji?

Eshte mese e vertete se, konceptet janë vetvetiu të ngushtuara, ne kontekstin e një diskursi biomjekesor që themelohet mbi dallimet e tyre, por e rendesishme ketu është që gjuha angleze e ndihmon kete lloj diskursi të shtjellohet lirisht, duke ia ofruar të gatshem materialin gjuhesor, ne menyre të tille që autorit (subjektit të diskursit perkates) i duhet veçse të ri-perkufizojte termin që do të perdore, jo të krijojte termin vete.

Ne rastin e gjuhes shqipe, fjaloret dygjuhesh nuk do të ndihmojne dhe aq shume sepse të japin gjithnje fjalen "semundje" si perkthim.

Po ashtu edhe një fjalor sinonimesh nuk do të na hynte ne pune sepse fjalen semundje do ta pershkruante ndryshe si:- lengate ndoshta edhe dergje, mirepo fjala "lengate" nenkupton "semundje të rende, kronike që të mberthen për një kohe të gjate ne shtrat" prandaj nuk i sherben perkthyesit si mjet pune.

Per krahasim një perkthyes nga anglishtja ne italisht nuk do të kishte veshtiresine për të zgjedhur midis fjaleve malattia, morbo, affezione, malessere, malanno, male dhe malore.

Ne krahasim me simotrat e saj evropiane me të levruara, gjuha shqipe na paraqitet njekohesisht edhe me e varfer për shkak të mungeses se sinonimeve. Na paraqitet edhe me abstrakte sepse me një fjale të vetme semundje kërkon të mbuloj një spekter kuptimor perndryshe të pasur ne dallesa.

Duke e sforcuar pak gjuhen shqipe mund ta perkthejme disease si patologji "çrregullim" dhe illness si "pamundje" duke e lene për të perkthyer fjalen sickness "semundje", por keshtu kemi mekatuar ne neologji, gje që e kishim vendosur ta perjashtonim që ne krye, sepse nuk është detyra e perkthyesit të krijojte fjale, duke e tradhetuar formen e brendshme të vete fjales, për aq kohe që si fjala semundje po ashtu dhe vete fjala pamundje i referohen fjales "mund", ne kuptimin që semundja është pamundesi, ose një lloj pafuqie për të funksionuar

normalisht për arsye shendetesore.

Fjala "patologji" tregon zakonisht ecurine e një semundje ndersa fjala "çrregullim" do të thote hiperonim për aq kohe sa jo çdo çrregullim është semundje.

Vete fjala semundje, ne gojen e një shqipfolesi cfaredo, është me shume mysafire se sa ne shtepine e vet. Ne zakonisht themi jam pa qejf, jam keq, nuk jam mire, kam një siklet, kam zene shtratin, nuk jam ne terezi etj, manifestime keto të fjales "illness" duke mos e emertuar semundjen por duke treguar menyren se si ne e perjetojme ose se si ne reagojme ndaj saj (ketu nuk po permend emertimet e drejtperdrejta të ndjesive siç jane: me perzihet, me sembon ne ije, me mbahet goja, me dhembin kryqet, me merren mende, me dridhen duart etj). Perkundrazi, ne një kontekst tradicional komuniteti (familja, shoqeria) do të priret të perdore zakonisht një eufemizem, ne rast se semundja identifikohet. Ne raste të tilla rolin e mjekut e luan zakonisht një person i cili mund të jete (nje mjeketar, një hoxhe, një plake, një barnatar etj) i cili nuk kuron "semundjen" por personin vete ose simptomat.

Pyetje dhe hipoteza

Te gjithëve ne jete na ndodhe të shkojme dhe të bejme vizita mjekesore të doktori.

Mbas vizites ndeshemi me fazen e shpjegimit të semundjes tone, ku shpesh here perballemi me terma të cilat nuk i kuptojme edhe pse keto terma janë ne gjuhen tone.

Pyetja eshte-Si rritet shkalla e veshtiresise kur na duhet të interpretojme dhe perkthejme terma nga një gjuhe të tjetra?

E pra kjo është akoma me e veshtire sepse gjate perkthimit ne duhet të japim ekuivalenten e të shprehurit nga gjuha percjellese të gjuha pritese.

Kjo ka të beje me rendesine e perdorimit të termit të duhur dhe për kete gjitmone perdorim mjetet tona dhe burimet tona me të sigurta ne menyre që perkthimi të jete i njejte me origjinalin sepse jo gjithmone mund ti besojme intuite.

Nje perkthim me cilesi ndikon gjitmone për një jete me të shendeteshme.

Rastet e perkthimit të termave mjekesore ne menyre të gabuar ne shoqerine shqiptare janë nga me të shumtat. Ketu mund të permendim rastet e perdorimit të maskave të fytyres të femrat, aty ku ngaterrohen ingredientet për shkak të gjuhes dhe pasojat janë nga me të ndryshmet, që nga skuqja e lekures, irritimi i lekures, kruajtja e lekures etj.

Raste të tjera mund të permendim dhe perdorimin e maskave të flokut ku pasojat nuk janë aspak të mira. Ketu mund të kemi të bejme me rrenie masive të flokut, djegie të flokut ashpersim të tij etj.

Nje tjetër pyetje që ngreme eshte:-Po sikur të behej



fjale për një çështje me të rëndësishme, një nderhyrje kirurgjikale të komplikuar?

Termi i përdorur do të përcaktonte ecurinë e shëndetit të një personi, prandaj saktësia linguistike ka rëndësi jetesore.

Perfundime

Veshtiresite në përkthim-interpretim nuk janë thjesht leksikore apo normative, por edhe konceptuale.

Shqipja ende i përgjigjet një kulture të përzgjedhur ndaj diskursit racional analitik përendimor, që në lemin mjekësor i ndan semundjet nga të semuret, duke i trajtuar si "entitete" me vete, të organizuara sipas kategorive jo vetëm horizontale por edhe ato vertikale.

Në baze të përfaqësimit krahasues të dyja disiplinat ejo e përkthimit dhe ajo e komunikimit veprojnë mbi bazën e disa supozimeve të përbashkëta:

- komunikimi nuk është një proces i drejtpërdrejtë ku mesazhi transferohet i pacenuar;
- komunikimi përtej kufinjve kulturore dhe gjuhësore duhet të pranojë themelet e ndryshme kulturore të gjuhëve;

- gjuha dhe kultura nuk janë koncepte të qëndrueshme apo sisteme të mbyllura, por sisteme të hapura, dinamike dhe fleksibël;
- gjuhët dhe kulturat nuk mund të kufizohen me kombet, pasi kufinjte mes tyre janë gjithmone e më pak të qarta.

Në këto pike mendojmë se kemi analizuar 4 elemente të rëndësishme: gjuhën, kulturën, përkthimin, komunikimin ndërkulturor dhe pame se si janë të ndërvuar njeri nga tjetri. Kështu gjuha ndikohet nga kultura dhe në reaksion zinxhir të dyja këto ndikojnë të procesi i përkthimit, proces gjatë të cilit nuk flitet me për një gjuhë dhe kulturë por për dy të tilla.

Këto lidhje dhe ndërvaresi janë të dukshme dhe të komentueshme kur flitet për gjuhë të mëdha. Në këto pike madhësia e gjuhëve nuk lidhet me numrin e folësve se sa me dominimin në sferën e rëndësishme siç është ajo mjekësore, dhe në një epokë globale si kjo e jona ku identiteti kombëtar vazhdon të trumbetohet fort gjuhët dhe kulturat dominuese janë më të sigurta në territoret e tyre.

Bibliografia

1. Adejunmobi, M. (1998) Translation and Postcolonial Identity. African Writing and European Languages. In: The Translator 4.
2. Aixela, J. (1996) "Culture Specific Items in Translation", në R. Alvarez dhe C. M. Vidal "Translation, Power, subversion", Clevedon: Multilingual Matters.
3. Allwood, J. (1976) "Lack of Understanding, Misunderstanding and Language Acquisition", në G. Extra and M. Mittner: Studies in Second Languages Acquisition by Adult Immigrants, Tilburg, Tilburg Studies in Language and Literature 6.
4. Appadurai, A. (1991): Global Ethnospaces : Notes and queries for a transnational Anthropology in Fox. RICHARD G. (ed). Recapturing Anthropology: Working in the Present. Santa. FE. School of American researches Press.
5. Argyle. M (1975) "Bodily Communication", London Methuen Barlund, D. C,
6. Bennet. M (1998) "Intercultural Communication : A current Prospective ", në Basic Concepts of Intercultural Communication. Yarmouth, Maine :Intercultural Press.